Oral History Kosovo

INTERVISTE ME MÜNIR CURI

Prishtinë | Data: 7 prill, 2019
Kohëzgjatja: 65 Minuta

Të pranishëm:

1. Münir Curi (I intervistuari)
2. Ebru Süleyman (Intervistuesja)
3. Donjeta Berisha (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:
() - komunikim emocional
{} - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:
[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin
Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Münir Curi: Unë jam Münir Curi, i lindur më 1949. Në Mitrovicë u linda por tashmë 65 vite jam këtu në Prishtinë. Për shkak të një detyre zyrtare të babait u bartëm nga Mitrovica në Prishtinë, në vitin '51. E në Mitrovicë e kishim familjen e madhe, nga ana e nënës por edhe nga ana e babait. Babai i babait, gjyshi im domethënë, ai ka qenë një berber i famshëm në Mitrovicë, edhe berber edhe dhëmbë nxirrte. Në atë kohë gjithmonë berberët nxirrnin edhe dhëmbë, bënin synete, bënin ilaçe. E gjyshi im ishte njëri prej tyre, Salih berberi ka qenë njëri prej berberëve të njohur.

Ebru Süleyman: Ju a e keni njohur gjyshin tuaj?

Münir Curi: E kam njohur, pak. Diku deri në moshën 10-15 vjeçare me të jam rritur por ndaras kemi qëndruar, ne në Prishtinë ata në Mitrovicë. Kështu që me ata vetëm kështu si musafir shkonim dhe për pushime, atje. Në dyqan shkoja atje rrija në dyqan. Ai ka qenë berber në Mitrovicë.

Ebru Süleyman: Ku e ka pasur dyqanin?

Münir Curi: Dyqanin e ka pasur ku është tregu i vjetër ku u ndërtua xhamia tani në Mitrovicë. Ka qenë një rrugicë e tëra me zanatlinjë, e aty ka qenë berber. Nxirrte dhëmbë, ilaçe bënte, synet bënte. Ka qenë një kirurg i mëparshëm. Edhe babai atëherë e ka marr zanatin dhe aty kësi, ka mësuar si t'i bie mandolinës.

Ebru Süleyman: Prej kujt e ka marr mandolinën?

Münir Curi: Aty ai e kishte një, ndihmësi i gjyshit tim edhe ai i binte mandolinës, dhe këtij i kishte pëlqyer, e ka marr dhe ka filluar me mandolinë sa ka qenë i vogël, mandolinës i binte aty. Ana e nënës sime këta në Mitrovicë njihen si rus. Sepse nga Rusia, në kohën e mbretit, mbreti i rusisë këta, pasi që kanë qenë muslimanë i ka dëbuar nga Rusia. Këta kishin shkuar në Konja, prej kësaj, prej Uzbekistanit, ata janë prej Uzbekistanit, dy vëllezër në Konja, pastaj prej Konjës kishin ardhur në Kosovë.

Ebru Süleyman: Në cilat vite kjo?

Münir Curi: Kjo para 500 viteve, para 600 viteve. Dy vëllezër kishin ardhur, njëri ka qenë *zaim*[1] e tjetri hoxhë. E hoxha jepte mësim kështu nëpër shkolla Haxhi Ahmeti dhe Mustafa, dy vëllezër ata kishin shkuar në Konja, prej Konjas kishin ardhur në Kosovë. Këtu këta, këtu i kanë krijuar familjet, gjërat. E këta në Mitrovicë i njohin si rus. "Ruski, Ruski" ju thoshin gjithmonë.

[1] Pronarë të tokave në Perandorinë Osmane.

Ebru Süleyman: Po, domethënë që vijnë prej asaj familjes?

Münir Curi: Po këta ishin dy vëllezër, dy familje, Mustafa dhe Ahmeti. Janë dy pjesë të familjeve. Domethënë nipërit, fëmijët e Mustafës dhe Ahmetit, nipat e tyre. Ata këtu e kishin krijuar shtëpinë, jetën e kanë krijuar, i kanë marr ato [traditat] e kësaj ane.

Ebru Süleyman: A ka mbetur? A kanë mbetur ato traditat e tyre që i kishin më parë në Uzbekistan apo diçka?

Münir Curi: Jo aq jo.

Ebru Süleyman: Domethënë ka kaluar kohë e gjatë.

Münir Curi: Sepse ka kaluar kohë, ata janë në Mitrovicë tani. Janë përshtatur me [traditat] e këtuhit. Ato traditat, traditat ruse ata i kishin hequr nipat, gjyshërit ata këtu ishin përshtatur me ato [traditat] e këtij rajoni, me jetën…

Ebru Süleyman: Domethënë kjo ishte nga ana e nënës tuaj?

Münir Curi: Ana e nënës, Zaim.

Ebru Süleyman: Babai juaj u lind në Mitrovicë?

Münir Curi: Babai u lind në Mitrovicë, nëna u lind në Mitrovicë por babai me detyrë atëherë ishte në Prishtinë ku po e krijonin radion. Pasi që minoritete kishte më shumë këtu. Shqiptarë, turq, romë, serbë e të tjerë, në atë kohë ky rajon ishte për Jugosllavinë, një rajon i veçantë. Pastaj radioja u themelua. Në vitin '48 u themelua radioja në Prishtinë. Aty ka pasur orkestër shqiptare, kishte orkestër serbe por orkestër turke nuk kishte. Atëherë ishte sistemi një partiak, Partia Komuniste parti tjetër nuk kishte. Domethënë që edhe populli ynë atëherë, populli turk ishte në atë parti. U formua Këshilli në Kosovë, qeveria, qeveria e Kosovës u formua, në atë qeveri kishim disa të afërm, u formua. Këtu ishte një orkestër turqit e përbënin por me këngë dasmash, *vauuvuv* {onomatope}, radios nuk i'u është përshtatur ai orkestër.

Babai im pasi që e donte shumë muzikën artistike turke duke dëgjuar gjithë ditën në radio kishte përparuar, ka filluar të luaj në *cümbüş*[2]. Pas mandolinës pastaj në shtëpi e kishin marr një *cümbüş*, ka filluar me *cümbüş*, duke e dëgjuar radion se përndryshe ai nuk kishte edukim muzikor. Me nota apo kështu, ato jo por kështu me vesh ka filluar t'i dëgjoj, ka filluar t'i bie *cümbüşit* dhe ka përparuar. E në atë kohë ishin themeluar shoqëritë, domethënë shoqëritë kulturore. Në Mitrovicë ka qenë kjo Shoqëria e Bashkimit, babai dhe tre shokë, katër veta e kishin formuar atë shoqërinë. Aty kanë filluar me muzikë.

Babai edhe këndonte këngë, zë të artistit kishte, shumë zërin e bukur e ka pasur, shumë të mirë. Edhe aty duke dëgjuar radio, ka bërë qejf për vete ka dëgjuar. Dhe ata duke bërë kështu muzikë emri i tij

[2] Cümbüş është një instrument turk me tela, me origjinë relativisht moderne. Ajo u zhvillua në vitin 1930 nga Zeynel Abidin Cümbüş si një instrument me zë të lartë që mund të dëgjohej si pjesë e një ansambli më të madh. Cümbüş është në formë të bangjos amerikane, me një tas prej alumini të rrumbullakët dhe me bord të lëkurës.

bëhet i famshëm në këtë rajon. “A qenka një Rasim, Rasim,” mbiemrin e kishte Ryshyt, “kush është ky Rasimi, kush është, Rasimi djali i Salihut. Rasimi, djali i Salih berberit, Salih ustait, djali i Salihut.” I Rasimit dhe i Rasim Salihut. Ashtu atij i ka mbetur Rasim Salihu. E tani ky orkestri, orkestri i Prishtinës, orkestri turk nuk i është përshtatur radios. Këngët e dasmave, këngë tallava, *bam bum bam bum* {onomatope}. Por kështu muzikë artisitke më plotkuptimin e fjalën ata kanë bërë këtu.

Ne i kishim këta kryesuesit këtu, i ndjeri Kadir Rauf, Sherafetin Sylejmani, Hashim Mustafa, ata kanë qenë kryesues në atë Këshill. Ata kërkuan që në radio te formohet edhe një orkestër me muzikë artistike turke. Shqip kishte, serbisht kishe, turqisht nuk kishe, këtu edhe turq ka, në këtë Kosovë kishte edhe turq atëherë, shumë kanë emigruar. Prej Këshillit vjen një lajmërim, “Rasim Salihun ta sillni në Prishtinë, do ta formoj orkestrin”. Ai kompleti, ai grup, domethënë grupin nga ajo shoqatë ta sjellin në Prishtinë. Bën, s’bën, bën, s’bën, kështu në vitin ‘51 babain tim e kanë ftuar këtu që ta formoj orkestrin.

Ebru Süleyman: E kanë ftuar?

Münir Curi: E kanë ftuar këtu, një banesë na dhanë neve. Kanë ardhur tre shokë, ka qenë Bajram Kirvesh, Adem Macula dhe Bedri Tumbak i binte darabukës. Babai i Suzan Kardesh[3].

Ebru Süleyman: Edhe ajo qenka nga Mitrovica?

Münir Curi: Edhe ajo është nga Mitrovica, kushërirë e afërt. Ai [Bedri Tumbak] i binte darabukës këtu por këtu nuk qëndroi sepse në Mitrovicë e kishte punën shumë të mirë. Babai im para se të merrej me muzikë së pari ishte berber. Domethënë edhe me profesion është berber. Por shumë është marr me muzikë pastaj ata të katërtit kanë ardhur këtu, e formuan një orkestër. Pak nga pak përparuan. Artista të zërit, babai edhe këndonte edhe i binte *cümbüşit*, për një kohë të gjatë, së pari në vitin ‘48 u formua radio.

Ebru Süleyman: Ku ishte në atë kohë radioja?

Münir Curi: Radioja ka qenë në Prizren. Prej ‘48-tës në Prishtinë e kanë themeluar radion. Ashtu një shtëpi e vogël ka qenë, madje thoshin ndërtesë banuese, bllok, në bllokun e parë aty ishte një shtëpi e vogël…

Ebru Süleyman: Ku po i bie saktësisht kjo?

Münir Curi: Duke shkuar kah Taukbahçja janë ato blloqet, e aty një shtëpi e vogël ka qenë mua më kujtohet, atëherë kam qenë i vogël, dy-tri vjet. E aty ka qenë një shtëpi e vjetër, një shtëpi kështu e rrënuar {me duar përshkruan}, aty radion e themeluan. Pastaj në një ndërtesë kanë kaluar, në ndërtesë, sepse ajo nuk ishte e përshtatshme, akustikë nuk kishte në atë shtëpi. Nuk kanë arritur të bëjnë gjë. Kaluan në një ndërtesë, përball saj, tani aty është një çerdhe e fëmijëve. Pikërisht ku ishte ajo shtëpi aty është tani çerdhja e fëmijëve.

Ebru Süleyman: Domethënë ku është Shtëpia e Pleqve, përball që është...?

[3] Këngëtare, aktore dhe grimere e famshme turke. Në vitin ‘68 familja e saj nga Mitrovica ka emigruar në Stamboll, Turqi.

Münir Curi: Përball Shtëpisë së Pleqve. E aty, pastaj filluan në ndërtesë, në përdhesë dhe në katin e dytë banesat, studiot e kështu gjëra. Në atë kohë nuk kishte inçizime por shkonte direkt, program i hapur. Drejtëpërdrejt, sepse nuk kishte studio, por ata aty filluan dhe aty punuan, punuan dhe shumë përparuan. Një gjë e madhe domethënë, një orkestër e madhe u formua. Sepse babai im shumë artistë i ushtroi, i ka ushtruar shumë mjeshtër të sazit[4]. Në Prizren, në Prishtinë, tani edhe këtu në vitin '51 u formua një shoqatë. Shoqata "Yeni Hayat"[Jeta e Re] u formua në vitin '51. Aty babai ushtroi këngëtarë, grupe të korit, gjithmonë me ata ka punuar, punoi, punoi… Shoqata "Gerçek" [E vërteta]. Shoqata "Gerçek" në vitin '69 e mori emrin Gerçek. Sepse aty në atë kohë para se të vinte babai kishte muzikantë. Domethënë këngëtarë por as nota nuk dinin asgjë, vetëm ashtu këngë dasmash kishin bërë ata, disa mbledhje, turqisht.

Por babain tim kur e sollën muzika këtu përparoi shumë, muzika artistike turke përparoi shumë. E në radio, në vitin '55, i ndjeri Rexho Mulliqi mjeshtër i madh, muzikant, e pyet babain tim, babai i binte edhe violinës, i binte edhe udit[5], i thotë, "Ti a ke edukim muzikor?", "Jo", "A mund t'i lexosh notat?", i kish thënë, "Jo nuk mund t'i lexoj." Ai e merr dhe ishte i pari që ia mësoi notat babait tim, kështu që pastaj babai prej revistave që vinin prej Turqisë, domethënë me këngë, me nota, gjithmonë prej aty ngadal-ngadal edhe më shumë e përsos muzikën. Falë Rexho Mulliqit, ai profesor, profesor i muzikës ka qenë, babain shumë e merrte pas vetes, dhe e donte po mendoj. Edhe muzikën artistike turke e donte shumë. Ka qenë bashkëshorti i Nexhmije Pagarushës. E aty, pastaj kanë përparuar, kanë përparuar, deri në kohën e luftës orkestri ka qenë gjallë, pas luftës orkestri u shua.

Ebru Süleyman: Domethënën deri në vitin '99 ka qenë orkestri?

Münir Curi: Ka pasur orkestër. Pas '99-tës nuk pran… nuk ka pasur buxhet, nuk ka pasur para, nuk kanë mundur t'i paguajnë këta muzikantët. E shumë muzikantë ka pasur, Ilir Birvenik u bë i famshëm aty, ka shumë, Ramadan, Iljaz, shumë artistë, Zeki Sadik ky i Ohrit. Zija Bekir i Gostivarit, ata gjithmonë këtu kanë përparuar.

Ebru Süleyman: Në Prishtinë?

Münir Curi: Në Prishtinë kanë përparuar. Ata kanë qenë muzikantë shumë me vlerë por fatkeqësisht kanë thënë që nuk ka buxhet. Jo orkestër shqipe nuk ka, orkestër serbe nuk ka, mos të ketë as turke. Por mjerisht! Ky është edhe pak faji i qeveritarëve tonë, qeveritarëve të tanishëm. Qeveritarët e atëhershëm e formuan atë, hapën shkolla, gjithçka bënë. Daja Kadri i ndjerë, falë tij turqit këtu përparuan shumë. Madje, madje në kushtetutën e 1974-tës, në Kushtetutën e Kosovës turqit nuk ishin [të drejta], por falë tij turqit u shtuan edhe në kushtetutë.

Ebru Süleyman: Domethënë janë njohur, si janë futur në Kushtetutë?

Münir Curi: Kush?

Ebru Süleyman: Turqit, në Kushtetutën e '74-tës?

Münir Curi: Në Kushtetutën e '74-tës pakica turke nuk u fut por i ndjeri Kadri Raufi, ishte në kryesinë e

[4] Sazja *(Saze)* ose Bakllama është një instrument muzikor me akordim që është përdorur në muzikën klasike osmane, popullore turke, perse, azere, asiriane, armene, nëpër Siri, Irak dhe Ballkan.
[5] Instrument me prerje e qafë të shkurtër, në formë dardhe, me 11 ose 13 tela të grupuar në 5 ose 6 kurse.

atij grupi të këshillit, “Në Kushtetutë edhe turqit do të futen si pakicë. Nuk bën pas kaq vitesh pa pasur pakicë turke.” Erdhi përkrahja për të, sepse vetëm një parti ishte, Partia Komuniste… Fadil Hoxha, Xhavit Nimani atë e shpallën nacionalist, “Shiko ti po bën problem”, “Nuk është problem!”. Vjen lajmi, “Edhe ata kanë të drejtë, aty po jetojnë, do të pranohen si pakicë”. Pakica turke, pastaj prej aty më vazhdoi.

Ebru Süleyman: E juve a ju kujtohet, ju kur keni ardhur në Prishtinë shumë i vogël keni qenë apo jo?

Münir Curi: Unë kam qenë një vjeçar. Prishtinën prej atëherë nuk e kujtoj por 60 vite qëndrova këtu, këtu u rrita.

Ebru Süleyman: Në cilën lagje jeni rritur, ku?

Münir Curi: Atëherë ishte tregu, tregu i tanishëm, tregu i gjelbër, aty është një ndërtesë e vjetër, ndërtesë e komunës, aty qëndronim ne. Ajo lagje, e gjithë ajo lagja ka qenë stacion i autobusit shumë kohë më parë. Para 40-50 viteve stacioni i autobusëve ka qenë aty. Aty ne jetonim, aty jam rritur, aty kishte edhe serbë, edhe shqiptarë edhe turq kishte shumë në atë lagje. Kështu që edhe serbët flisnin turqisht, edhe turqit serbisht, kështu ishte jeta aty, si një shtëpi ka qenë ajo lagje, një lagje shumë e bukur ka qenë aty.

Ebru Süleyman: Por aty ishte periferia ndoshta pak më larg prej qendrës së qytetit?

Münir Curi: Qyteti ishte i vogël atëherë nuk ishte aq i madh. Më i vogël, edhe ajo ishte menjëherë afër qendrës. Aty ka qenë qytet i vogël, aty ajo lagje edhe ashtu në Prishtinë të gjitha lagjet dihen. Prishtina ka qenë si një kopsht zoologjik. Lagja e Keçilerëve, lagja e Maçkallarëve, lagja e Siçanëve, lagja e Tavukçillarëve [nga gjuha turke: keçi-dhia, maçka-maca, siçan-miu, tavuk-pula], kopsht zoologjik ka qenë Prishtina.

Ebru Süleyman: Këta domethënë mbiemra a?

Münir Curi: Mbiemra, në lagje ato mbiemra ju kanë mbetur. Lagja e Keçilerëve, lagja e Tavukçillarëve, lagja e Maçkallarëve, lagja e Siçanëve, ku është tani “Hotel Sirius” apo cili është ai, “Bozhuri” që ka qenë.

Ebru Süleyman: “Swiss” ku është?

Münir Curi: Ajo rrugica teposhtë, rruga e Beogradit ka qenë, aty ka qenë lagja e Siqanëve. Maçkallarët kanë qenë aty në Tophane. Siçanët edhe Tavukçillarët edhe ata kanë qenë në një rrugicë aty në Tophane. Kështu Prishtina ka qenë një kopsht zoologjik. Keçilerët, Maçkallarët, Tavukçillarët, Siçanët, gjithmonë kështu ato familjet e atyre lagjeve, më së shumti familjeve që kanë jetuar në ato lagje ju kanë lënë kësi emra.

Ebru Süleyman: Ju a keni pasur vëlla, motër?

Münir Curi: Ne kemi qenë tre vëllezër, njëri më i vogli vdiq, Fikreti. Dhe një vëlla e kam në Turqi, jeton në Avgjillar.

Ebru Süleyman: E këtu në Prishtinë bashkë jeni rritur?

Münir Curi: Në Prishtinë bashkë jemi rritur. Ky i ndjeri Fikreti këtu u lind, unë dhe vëllau pas meje në Mitrovicë.

Ebru Süleyman: Domethënë ju jeni më i madhi?

Münir Curi: Unë kam qenë më i madhi.

Ebru Süleyman: Çka bënit në lagje?

Münir Curi: Në lagje me fëmijët luanim me top, luanim fshehurazi. E kishim një park përball shtëpisë, tani ato toka i ka marr televizioni, disa dyqane kanë qenë përreth. Aty ka qenë Qendra Pionierëve, Qendra e Pionierëve, një park i madh aty, luanim fudboll aty, luanim ping-pong, aty gjithmonë mblidheshin fëmijët, kështu…

Ebru Süleyman: E a ju kujtohet aty një ndërtesë tani që është e rrënuar disi, një ndërtesë e vjetër aty, që treguat për këtë parkun, përball?

Münir Curi: Atë tani që po e restaurojnë.

Ebru Süleyman: Çka ka qenë ajo?

Münir Curi: Unë atë madje madje... ka qenë ndërtesa e ushtrisë. E ushtrisë, në atë kohë ushtarët e Jugosllavisë qëndronin aty. Por…

Ebru Süleyman: Shtëpia e oficerëve.

Münir Curi: Në periudhën osmane aty… edhe unë qëndrova në atë shtëpi për disa muaj. Bodrumet ishin burgje, në periudhën osmane. Pastaj u bë shkollë, nuk e di çka tjetër u bë aty. Ajo është një ndërtesë historike.

Ebru Süleyman: Prandaj pyeta çka ka qenë.

Münir Curi: Ajo është një ndërtesë historike. Ndërtesë e ushtrisë, ushtarët kujdestar prej aty dilnin, shpërndaheshin nëpër qytet por para kësaj në periudhën osmane, unë sa e mbaj mend aty ka qenë burgu. Sepse unë kam banuar në atë ndërtesë, kur hyja në bodrum e njejta gjë, ishin ato gjërat e burgut.

Ebru Süleyman: Në bodrum domethënë.

Münir Curi: Në bodrum. E pastaj aty…

Ebru Süleyman: Si u rrënua ajo?

Münir Curi: Nuk u rrënua ajo.

Ebru Süleyman: A u dogj?

Münir Curi: Jo ajo ndërtesë ishte e vjetër, gjë e kalbur. Tani atë po e rregullojnë, pasi që është një ndërtesë historike po e riparojnë atë. E aty, muzeu ku është tani, te xhamia, afër xhamisë së Çarshisë ajo ka qenë ajo e osmanëve, Shtëpia e Qeverisë, si komuna e dikurshme, komuna e tanishme. Aty ka qenë kjo e osmanëve, kjo shtëpia, Shtëpia e Qeverisë. Administrata ka qenë aty, administrata osmane, ka qenë Shtëpia e Qeverisë. Tani aty u bë muzeu.

Ebru Süleyman: Ndërtesë e bukur.

Münir Curi: Ndërtesë e vjetër madje arkitekti ishte osman.

Ebru Süleyman: E ju sa keni qenë duke u rritur domethënë babai juaj erdhi këtu, ka punuar në orkestër. Domethënë çdo ditë shkonte në radio bënte muzikë.

Münir Curi: Puna ka qenë normale në radio çdo ditë, domethënë kështu përgadiste, muzikantët i përgadiste, këngët i përgadiste.

Ebru Süleyman: A ju merrte edhe juve me vete?

Münir Curi: Më merrte nganjëherë, kur kam qenë i vogël më merrte, atëherë filloi kështu, studioja u bë, domethënë inçizimet, programi nuk shkonte drejtëpërdrejt, gjatë inçizimeve. Unë rrija aty në studio me gojë të mbyllur, as një zë nuk e lëshoja {shpjegon me duar} nganjëherë aty.

Ebru Süleyman: Kjo ka qenë në kohën kur janë zhvendosur në ndërtesën e re të radios.

Münir Curi: Ndërtesa e re e radios.

Ebru Süleyman: A ka qenë më moderne aty?

Münir Curi: Më moderne, pak më ashtu u bë aty. Sepse së pari, që thash si banesë radioja pas bllokut, u vendos pastaj në ndërtesën tani televizioni ku është, në atë ndërtesë ka qenë. Deri të '70-tën, deri '71-'72-tën. Atëherë përfundoi kjo ndërtesa e radios, atëherë përfundoi dhe të gjithë u zhvendosën atje, kjo ndërtesë i mbeti televizionit. Televizioni '69-tën apo '71-tën nuk po më kujtohet saktë, televizioni i Prishtinës filloi. Program turk kishte edhe më parë por jo në Prishtinë, ne radion e Beogradit, në televizionin e Serbisë bëheshin programet. Kështu nxirrte [programe] në emër të radios së Prishtinës. Turqisht, shqip, serbisht të gjitha prej Beogradit nxirreshin. Gazetari i parë Shakir Maksuti ka qenë, ai prej Beogradit i jepte lajmet.

Ebru Süleyman: Kjo domethënë para se të hapej këtu televizioni?

Münir Curi: Para se të hapej televizioni, ka qenë aty, në Beograd ka qenë. Prej Beogradit jepeshin programet. Pastaj këtu, pas të '70-tave televizioni u hap këtu. Kështu që kishte edhe program turqisht, edhe shqip, edhe serbisht, madje edhe në gjuhën rome kishte.

Ebru Süleyman: E në cilën periudhë u përhap televizioni nëpër shtëpitë e njerëzve për shembull?

Münir Curi: Njerëzit nëpër shtëpi, në atë kohë televizionet... në vitet '61-'65 kanë filluar televizionet këtu të punojnë. Kështu që njerëzit për ta shikuar Prishtinën pas të '70-tave direkt kanë pasur [televizionin] e Prishtinës, RTK [RTP] ka qenë.

Ebru Süleyman: I shikonit domethënë programet e këtuhit, kishte edhe turqisht.

Münir Curi: Kishte edhe turqisht, kishte…

Ebru Süleyman: Çfarë programe kishte?

Münir Curi: Kishte programe të lajmeve, një herë në javë ishin programet muzikore, programet argëtuese, programet për fëmijë, kështu i bënin nganjëherë po jo edhe aq shumë, një herë në javë ishte, kështu. Dy orëshe, gjysmë orëshe disa programe jepeshin.

Pjesa e Dytë

Ebru Süleyman: Ju në cilin vit e keni filluar shkollën?

Münir Curi: Unë shkollën '56-tën e kam filluar.

Ebru Süleyman: Në cilën shkollë keni shkuar?

Münir Curi: Shkollën e parë që e kam filluar, ka qenë shkolla "Emin Duraku" në Prishtinë, klasën e parë në turqisht e kam filluar aty.

Ebru Süleyman: Domethënë edhe aty kishte klasë në gjuhën turke?

Münir Curi: Ka qenë një klasë turke aty. Pastaj në klasën e dytë në shkollën "Meto Bajraktari" u zhvendosëm të gjithë, aty në "Meto Bajraktari" ishin dy klasë. Dy klasë turke, e teta pesë dhe e teta gjashtë.

Ebru Süleyman: Klasët tuaja?

Münir Curi: Dy klasë turke i kishim, gjithsej 40 nxënës ishim, shumë nxënës ka pasur.

Ebru Süleyman: Kjo domethënë para se të shpërnguleshin?

Münir Curi: Më?

Ebru Süleyman: Atëherë nuk emigronin aq?

Münir Curi: Ende '50-tën deri '64-tën, sepse unë '64-tën e kam përfunduar shkollën fillore. Shkollën fillore e përfundova '64-tën pastaj shkolla e mesme, vetëm një shkollë e mesme turke ishte, gjimnazi {me duar tregon}. Unë ju kam përkushtuar gjimnazit por unë shumë, kështu punën e doja, zanatin, shumë jam marr me rrymë, shumë. Për mua ishin më interesante ato. E tani në gjuhën turke nuk kishte shkolla elektro-teknike, unë pastaj fillova me gjimnaz. Në gjysmë vjetorin e parë, këtu në Prishtinë u hap diçka, domethënë teknik për televizion, një shkoll u hap. Shkolla ushtarake e kishte hapur, domethënë si zanat. Dhe unë ika prej gjimnazit, në gjysmëvjetor e regjistrova veten në atë shkollë, teknik i radio televizionit. Atë…

Ebru Süleyman: E prej ku filloi t'ju pëlqej juve?

Münir Curi: Ku ta di prej fëmijërisë, duke shikuar atë, domethënë fizikën e kam dashur shumë në shkollë. Në fizikë shikoja rryma si lëvizte, si vjen deri këtu, {shpjegon me duar}, unë shumë jam marr me ato, në [orën] e fizikës. Mua ajo më hyri brenda, prandaj edhe në shtëpi fillova bëja ca gjëra vet, pastaj në shkollë mjeshtër i televizorit, shkollën e mesme aty e përfundova.

Ebru Süleyman: Në cilin vit ishte kjo?

Münir Curi: '63- '64.

Ebru Süleyman: Keni filluar?

Münir Curi: '66-tën e përfundova, '64-tën apo '63-tën… nuk po e di, kam harruar për besë, nuk më kujtohet tani, e kam diplomën në shtëpi prej asaj kohe. Pastaj një dyqan e hapa, tani ku është katedralja aty një dyqan ka qenë. Pastaj unë pas shkollës një dyqan, bashkë me një shok e hapëm dyqanin për rregullimin e radiove dhe televizorëve. Aty kanë qenë disa baraka, dyqane, aty e kam hap por nuk ka zgjat shumë se unë shkova në ushtri, '78-tën. Shkova atje në ushtri. Kur u ktheva prej ushtrisë jam marr prapë me këto gjëra, ishte detyrë e imja, radiot… lidhjet. Me aeroplana, unë ushtrinë në aviacion e bëra, në Sombor, aviator, aviacion i komunikimit. Me radio me gjëra të tilla, me ato sipas profesionit, ashtu mua më kanë veçuar. Kur u ktheva prej ushtrisë shikova për punë, këtu ka qenë një fabrikë elektrike "Energo Invest".

Ebru Süleyman: Si e ka pasur emrin?

Münir Curi: "Energo Invest", siguresa elektrike bënte, gjëra të tilla. Siguresat e tensionit të lartë, nuk e di çfarë siguresa, dhe mua më pëlqeu ajo, aty shkova. Pak edhe me të njofshëm, pasi që baba e kisha Rasim Salihun (qesh) aty u pranova. Aty unë e fillova punën.

Ebru Süleyman: Ku ka qenë ajo?

Münir Curi: Ajo ka qenë diku 7 kilometra prej Obiliqit, Caravodica është një fshat aty. Domethënë në atë kohë atje ka qenë termocentrali. Në atë ndërtesë, pastaj fabrika u hap, ja për këto siguresat, dhe unë aty fillova. Unë vazhdova, vazhdova, për tu bërë kryeshef, isha i detyruar ta paguaj një arsimim të lartë. Ata mua në shkollën teknike të Mitrovicës, më kanë dërguar atje në Shkollën e Lartë Profesionale. Atje njejtë për energji elektrike, makineri automatike, domethënë…

Ebru Süleyman: Lidhur me makineritë automatike…

Münir Curi: Patjetër është dashur të arsimohem, edhe dy vite i kam përfunduar aty në Shkollën e Lartë Profesionale. Pastaj jam kthyer në fabrikë si kryeshef edhe si shef në rregullim punoja. Domethënë lidhur me makinat, gjërat e prishura, edhe tre shokë i kisha aty afër me ata [punoja]. Unë isha shef ata merreshin me makinat. Por ato fabrika u zhdukën të gjitha, përfunduan.

Ebru Süleyman: Atëherë prej nga ishin punëtorët, a ishin prej të gjitha vendeve të Kosovës?

Münir Curi: Prej të gjitha vendeve të Kosovës, çdo vendit, çdo…

Ebru Süleyman: Si ka qenë jeta me punë?

Münir Curi: Au, shumë! Puna, në punë shkoje në shtatë të mëngjesit, në tre e përfundoje. Nganjëherë i pari, i dyti ndërrim, kishte ndërrime, *smena* [serbisht - ndërrim]. Mbeteshim prej treve deri në njëmbëdhjetë të natës, autobusi vinte na merrte, na shpërndante nëpër shtëpia. Kishim gjellë aty, kishte kuzhinë aty në fabrikë, ushqim kishte, gjithçka kishte. Pagat ishin të mira, fabrika punonte shumë mirë.

Ebru Süleyman: E për sa kohë keni punuar aty?

Münir Curi: Hë?

Ebru Süleyman: Sa keni punuar në fabrikë?

Münir Curi: Unë 38 vite, prej '69-tës deri '99-tën.

Ebru Süleyman: '99-tën domethënë…

Münir Curi: '99-tën u bë lufta por pas luftës u kthyem prapë në fabrikë. 2003-tën fabrika u privatizua, u shit. Prej 2003-tës pastaj ne prej aty… fabrika u mbyll.

Ebru Süleyman: Domethënë pas privatizimit punëtorët e vjetër i kanë larguar nga puna?

Münir Curi: Disa i kanë larguar, një pjesë ka mbetur, disa veta, ata që e blenë e vazhduan pak, pak, disa vite, me po të njejtën punë. Ne mbetëm diku 10-15 veta por shumica u largua nga puna. Kështu…

Ebru Süleyman: A ju është njohur pensioni? Gjithë ato vite?

Münir Curi: Po.

Ebru Süleyman: U njoh? Mirë.

Münir Curi: U pensionova (qesh). 30 vite punë… Madje shumë më shumë...

Ebru Süleyman: E kur ishit i ri kështu në qytet ku dilnit, çka bënit, me kë dilnit?

Münir Curi: Eh në atë kohë qyteti nuk ishte kështu, shumë më i vogël ishte, shumë ashtu, të rinjtë e kishin, korzo i thoshin. Ky sheshi Nëna Terezë, aty shëtiteshim. Të rinjtë aty mblidheshim në mbrëmje në ora shtatë, deri në dhjetë aty korzoja. Takoheshim aty, rrinim, bënim muhabet. Kështu… por tani këto nuk janë më.

Ebru Süleyman: Tani nuk ka më a?

Münir Curi: S'ka gjë prej tyre.

Ebru Süleyman: Kë e kishit shok, me kë rrinit?

Münir Curi: Kishte edhe serbë edhe shqiptarë, atëherë nuk kishte kësi ndarje shumë, gjithmonë kemi qenë edhe më romë edhe me të gjithë. Në Prishtinë ishin tri lagje, tri lagje të romëve ishin. Të serbëve, shqiptarëve, romëve dhe romë turk kishte. Ky Divan Jolli, ja ky {tregon me dorë}...

Ebru Süleyman: Çfarë gjuhe flisnin? Ashtu a?

Münir Curi: Po. Domethënë romët turk ishin në Divan Jolli. Romët serbë, Moravska është lartë te parku, ata ishin romë serbë. E shqiptarët ata ishin lartë kah xhamia e Llapit, mahalla e ashkalive. Domethënë kanë qenë tri [lagje]. Divan Joll, romët turk, kishe edhe romë që kishin ardhur nga Turqia.

Ebru Süleyman: Turqisht flisnin a?

Münir Curi: Turqisht flisnin, në shkollë turke shkonin. Në klasën time ishin tre romë por flisnin turqisht. Te Divan Jolli kanë qenë romët turk. Lart te Moravska kanë qenë serbët, përtej xhamisë së Llapit lart, mbi hekurudhë ata ishin ashkali, romë shqiptarë. Shqip flisnin, shqip...

Ebru Süleyman: E a ju kujtohet juve qyteti kur ka filluar kjo korzoja dhe të ndryshoj ajo pjesa, të ndërtohen ndërtesa të reja, ndoshta keni qenë shumë i vogël por a ju kujtohet kur u bë ndonjë gjë e re në Prishtinë?

Münir Curi: Më kujtohet ky "Sirius Hoteli" kur u ndërtua atëherë ka qenë "Bozhur". Aty ishte një xhami.

Ebru Süleyman: Po. A ju kujtohet ajo xhamia?

Münir Curi: Xhamia më kujtohet. Ajo xhami u rrënua aty u bë hoteli, ka qenë xhamia e Llokaçit. Aty një, madje madje ende është një shatërvan[6] aty para teatrit, ai shatërvan më kujtohet shumë mirë. Eh, në Prishtinë kishte edhe teatër të fëmijëve. Tani ku është ndërtesa e Qeverisë aty ka qenë një rrugë {tregon me duar}, aty ka qenë teatri i fëmijëve "Boshko Buha". Kishte programe edhe serbisht edhe turqisht aty, për fëmijët, shkonim aty pas shkollës në teatër (qesh). Shumë…

Ebru Süleyman: Domethënë ajo ndërtesë e re aty fare s'ka qenë? Tani kjo e Qeverisë…

Münir Curi: Jo, jo, jo. Posta, posta e vjetër ka qenë aty, tani gjatë luftës u rrënua, e aty ka qenë një rrugë kështu teposhtë {shpjegon me duar}, dilte te komuna. Prej aty ka qenë një rrugicë dilte te komuna, e aty ka qenë një teatër, teatri i fëmijëve "Boshko Buha" (buzëqesh).

Ebru Süleyman: Aty shkonit?

Münir Curi: Aty në fëmijët shkonim, shikonim. Ka qenë, ishte një teatër "Maçoku me çizme të verdha", "*Maçak u Çizmama"* [serbisht - Maçoku me çizme] ka qenë një teatër, i ndjeri Hamdi Begolli luante në atë teatër (qesh). Aty shkonim…

Ebru Süleyman: Pastaj, më vonë keni qenë në gjimnaz, pastaj në këtë shkollën teknike çka bënit?

---

[6] Shatërvani është një lloj fontane apo burim i ujit që zakonisht ndërtohet në oborr apo hyrje përpara xhamive me qëllimin kryesor sigurimin e ujit për pije ose abdese rituale për disa njerëz në të njëjtën kohë, por edhe si element vizual ose dekorativ.

Münir Curi: Gjimnazin e kam lënë, kam dal prej gjimnazit, e doja zanatin, e vazhdova zanatin, pastaj në Shkollën e Lartë Profesionale shkova. Në shkollën teknike të Mitrovicës, Shkolla e Lartë Profesionale, pastaj prapë u ktheva në punë, sepse mua puna më ka dërguar në atë Shkollën e Lartë Profesionale, sepse kryeshef nuk do të mund të bëhesha pa e përfunduar Shkollën e Lartë Profesionale.

Ebru Süleyman: E kur keni punuar në atë dyqanin me shokët që thatë te Tre sheshirat, apo ku ishte aty, si ka qenë ai vend, aty ka qenë një shkollë para se të bëhej katedralja.

Münir Curi: Shkolla ishte por aty pak para shkollës semaforët ku janë, afër KEK-ut aty ka qenë një boshllëk kështu një hapsirë, nuk ishte ajo rruga teposhtë, rruga për Fushë Kosovë nuk ishte. Ka qenë një rrugë tjetër andej, kalonte pas katedralës, dilte atje ku janë bërë dyqanet tani, aty ku janë bërë disa dyqane, disa gjëra, dilte poshtë. Aty nuk ka pasur, aty kanë qenë dyqanet, dyqanet tona. Atëherë nuk kishte semafora, asgjë nuk kishte aty. Ata semaforat filluan të '70-tën, pas të '70-tës pasi u ktheva unë nga ushtria ai vend u hap, u ndërtua, u bë rruga, udhëkryqi.

Ebru Süleyman: E me bashkëshorten kur jeni njohur?

Münir Curi: Hë?

Ebru Süleyman: Me bashkëshorten, gruan kur jeni njohur?

Münir Curi: Me gruan jam njohur, edhe ajo punonte aty, daktilografe ka qenë, e me të aty jemi takuar. Aty kemi marr një vendim të martohemi (buzëqesh).

Ebru Süleyman: Në cilin vit jeni martuar?

Münir Curi: '74-tën.

Ebru Süleyman: Ku? Ku e keni bërë dasmën.

Münir Curi: Dasëm nuk bëmë ne, pak (qesh), kështu që shpëtuam pa u hargjuar.

Ebru Süleyman: '74-tën jeni martuar?

Münir Curi: '75-tën u lind vajza, Neshe. Pastaj edhe tre fëmijë i kam. Berkant, Bylent, Gjoshkun.

Ebru Süleyman: Bashkë në Prishtinë. Në Prishtinë keni jetuar?

Münir Curi: Në Prishtinë 65, 70 vite në Prishtinë. Unë jam '49-sh, domethënë tani 70 vjeçar edhe disa muaj i mbushi 70 vjet. Kështu që unë 70 vite jam në Prishtinë.

Ebru Süleyman: A ju kujtohet kur lumenjtë ishin të hapur?

Münir Curi: Kanë qenë dy lumenj, dhe kanë qenë lumenj shumë të mirë ata. Eee, lumi Prishtevka dhe Vellusha ajo rruga prapa teatrit, aty kalonte Vellusha, Prishtevka ka qenë pas pazarit por në vitet e '70-ta ato u mbyllën. Sepse u mbush qyteti me lloje të ndryshme njerëzish atëherë, kanalizimet i lidhnin me lumenj, i vinte era qytetit. Patjetër është dashur të mbyllen ata lumenj. Kështu...

Ebru Süleyman: E ju a keni mësuar prej babait t'i bini ndonjë instrumenti?

Münir Curi: Unë jo por nipat u mësuan (qesh). Fëmijët u mësuan, unë nuk mund të bëhem mjeshtër si ai por prapë mund të bëj diçka.

Ebru Süleyman: E si ka qenë të rritesh ashtu, a vinin muzikantë në shtëpinë tuaj, kur ishit të lirë a bënit ndeja?

Münir Curi: Ohoo shumë! Tavuk Bahçja, Gërmia, aty mblidheshin qytetarët, bënin muzikë, bënin gjellëra aty. Shumë ditë argëtuese i kemi kaluar aty. Në Tavuk Bahçe, në Gërmi mblidheshim. Në atë kohë vetura, nuk kishte shumë vetura, me qerre e kuaj, në qerre të madhe mblidheshin saçat, ku ta di tenxheret, "Hajde në Gërmi", në Gërmi bënin gjella, mblidheshin të gjithë qytetarët aty, ndejë, muzikë, lojëra. Në Tavuk Bahçe njejtë bëhej ashtu më parë. Këtu lart kishte vreshta…

Ebru Süleyman: Ku?

Münir Curi: Te ky Dragodani. Edhe aty mblidheshin, në vreshta, atje në vreshta bënin muzikë, ndeja, gjithë Prishtinën kështu e shihnim (buzëqesh).

Ebru Süleyman: Shumë mirë, tjetër, te ky vend më parë kanë qenë kopshtet apo jo?

Münir Curi: Ku?

Ebru Süleyman: Ja këtu, këtu ku jemi tani, ajo pjesa e stadiumit.

Münir Curi: Po në atë pjesën e stadiumit kishte kopshte, ka pasur në atë pjesë, ka pasur. Ka pasur lakra. Në atë pjesë ka pasur kopshte. Edhe ka pasur ku është Dardania, edhe në atë pjesë ka pasur kopshte të mëdha.

Ebru Süleyman: E të kujt ishin këto kopshtet?

Münir Curi: Private, të njerëzve, të shtetit nuk kanë qenë ato, private. Kopshte ka pasur aty.

Ebru Süleyman: Vitin e Ri a e festonit? Vitin e Ri?

Münir Curi: Oh, çfarë Vita të Ri bëheshin, çfarë Vita të Ri bëheshin! Turqit i bënin në "Grand", atëherë "Bozhuri" ishte kështu restaurante të mëdha, kështu bëhej {tregon me duar}, çfarë Vita të Ri kishte eeeh! Përfunduan ato të gjitha…

Ebru Süleyman: E pse tani janë pakësuar këto, këto aktivitetet, këto gjërat? Mos ndoshta për shkak se njerëzit janë shpërngulur e kemi mbetur pak në numër?

Münir Curi: Jo, shoqata "Gerçek" ka vazhduar por ja që... Tani askush nuk është financiarisht aq mirë. Më parë kishte të gjithë punonim, kishte zanatlinjë, kishte shumë kësi gjëra. Ja këtu te {tregon me dorë} *spomeniku* [serbisht - përmendore] ku është, aty ishte një çarshi e vjetër, çarshi e vjetër. Aty kishte zanatlinjë, edhe shkonin kështu {shpjegon me duar} dilnin, ky Kastrioti, aty kah Skenderbeu dilte një rrugë, aty kishte litar bërës, bënin penjë, litarë. Kishte teneqexhi, kishte rrobaqepës,

çeshmexhi, berbera. Lloje, lloje të zanatlinjëve kishte aty një kohë, por ajo në vitet e '70-ta u prish dhe këto ndërtesa [u ndërtuan] aty.

Ebru Süleyman: Po. E ai vend domethënë fillon pikërisht prej xhamisë së Çarshisë, prandaj...

Münir Curi: Prej xhamisë së Çarshisë e drejt *spomenikut* aty ka qenë një rrugë, aty i bënin ato gjërat për biçikletë…

Ebru Süleyman: Garat me biçikletë?

Münir Curi: Garat me biçikleta, garat me motoçikleta. Ajo rrugë ishte komplet Divan Jolli, prej Gërmisë vinin kështu drejt shkallët, ku janë ato shkallët prej aty ka qenë Divan Jolli. Aty kanë qenë disa dyqane, disa dyqane të vogla të vjetra të zanatlinjëve, rrobaqepës, të plisave, lloj-lloj zanate kishte aty, edhe orëtar gjithçka kishte aty.

Ebru Süleyman: Domethënë dyqanet e zanatlinjëve të të gjithë qytetit kanë qenë aty?

Münir Curi: Të gjitha kanë qenë aty, aty të gjithë zanatlinjtë kanë qenë. Zanate të lloj-llojshme. Tani më nuk ka zanate të tilla.

Ebru Süleyman: Janë shpërndarë.

Münir Curi: Jo, jo. Në atë kohë litar bërësit, penjtë nuk i blenim në pazar por shkonim aty te litar bërësit. Ishin ca romë, bënin penjë, litar e gjëra aty, por ata më nuk janë. Kishte berbera, kishte orëtar…

Ebru Süleyman: Domethënë të '70-tave?

Münir Curi: Të '70-tave atëherë filloi komuna tani ku ta di bënte ndërtesa, ato ndërtesat ndërtoheshin në atë kohë, posta u ndërtua.

Ebru Süleyman: E si mendoni ju, a ka qenë patjetër të vendoset pikërisht te vendi i Çarshisë së vjetër?

Münir Curi: Jo valla nuk ka qenë patjetër por shiko aty ka qenë pak arkitektura osmane.

Ebru Süleyman: Aty te Çarshia?

Münir Curi: Çarshia ka qenë e arkitekturës osmane, e tani për t'i shlyer gjërat osmane, ato pak, pak kishte nacionalizëm, ndaj turqve. Atë patjetër është dashur ta heqin që të mos mbetë shenjë, diçka me shenjë osmane.

Ebru Süleyman: Domethënë kjo ka qenë politikë e Jugosllavisë a?

Münir Curi: Jo jo, politika rajonale e Kosovës. Politika rajonale ka qenë ashtu. Sepse Jugosllavia në atë kohë, Kosova në vitet e '70-ta ka qenë e vetëqeverisur. E kishte kushtetutën e vet, kushtetutën e vitit '74, e në atë vakt më Jugosllavia nuk kishte diçka.

Ebru Süleyman: E pastaj a ju kujtohet të '80-tën, apo '81-tën ka qenë protesta e parë e madhe?

Münir Curi: Protestat e para ‘81-tën.

Ebru Süleyman: A ju kujtohet si ka qenë kështu gjendja, çka bëhej nëpër qytet?

Münir Curi: Unë gjatë protestave ashtu ka qëlluar që kam qenë në rrugë dhe i kam dëgjuar protestat. Situata ka qenë pak e tensionuar. Situatë e tensionuar ka qenë. Tash me kërkesat e këtyre, atyre ju kundërvynë, ju kundërvynë serbëve, por shqiptarët kishin të drejtë {ngrit duart}, atëherë ka qenë sistemi një partiak me Partinë Komuniste. Kosova u njoh me një kushtetutë të veten, në kushtetutën e vitit ‘74 por ajo serbëve nuk ju përshtat. Sepse atëherë Kosova të gjitha i mori në dorë, qeverisjen. Serbët nuk kishin këtu aq... Vetëm se nuk e kishte emërtimin zyrtar republikë, por diçka të tillë ka pasur.

Ebru Süleyman: Domethënë ashtu jeta, të jetuarit, vendimet, gjërat ishin më të lira?

Münir Curi: Më të lira, më të lira. Vendimet këtu, domethënë as policia serbe as askush, këtu pa u dhënë vendimi ata nuk hynin në Kosovë. Këtu në Këshill merrej vendimi pastaj ata… atëherë pak…

Ebru Süleyman: E si ka qenë kështu atëherë jeta? Normale?

Münir Curi: Për neve normale. Tek ne nuk kishte ndarje. Unë po them, ne bënim mbledhje me serbët, dhe me këta i bënim disa *žurka* [serbisht - ndeja], të rinjtë mblidheshim nëpër shtëpia…

Ebru Süleyman: Kur kanë filluar të ndahen, të mos rrinë bashkë më?

Münir Curi: Pas ‘81-tës. Domethënë pas kryengritjes së parë, pas asaj filloi. Madje edhe korzoja u nda, pjesa e serbëve, pjesa shqiptare e korzos, korzoja u nda në dy pjesë. Kështu që pas ‘81-tës filloi të shkoj kah e keqja.

Ebru Süleyman: Domethënë ato grupet që rrinin bashkë u ndanë?

Münir Curi: Edhe ata u ndanë, të gjithë u ndanë. Një korzo ka qenë, edhe shqiptarët edhe serbët edhe turqit, të gjithë kalonim në një rrugë, ashtu shëtisnim… Pastaj pas ‘81-tës u ndanë, serbët në një anë, turqit, shqiptarët, muslimanët në një anë.

Ebru Süleyman: Pastaj ajo vazhdoi më tutje?

Münir Curi: ‘89-tën, e dyta ‘89-tën, ‘99-tën tashmë Millosheviqi erdhi në pushtet ai filloi të bëj më shumë presion. Nxorri prej punës, prej shtëpisë i dëboi, prej punëve i nxorrën njerzit. Sepse shumica atë nuk e pranuan. Domethënë kushtetutën serbe nuk e pranuan. Pastaj Millosheviqi i dëboi prej punës, qindra persona dolën nga puna. Shkollat i mbylli, mjaft më. Pastaj filloi lufta.

Ebru Süleyman: Gjatë luftës a keni qenë këtu?

Münir Curi: Ne kemi dal në Bllacë, pas Bllacës në Maqedoni, prej Maqedonisë në Turqi dola. I kisha dajët në Turqi, i kishim kushërinjtë, vëllaun e kisha atje, atje mbetëm, në kamp. Kur përfundoi lufta e ‘99-tës këtu u kthyem prapë. E në atë kohë i ndjeri Kadri Rauf, për turqit shumë gjëra ka bërë këtu. Nënkryetar kur ka qenë në atë qeverisje, për turqit shumë [ka bërë], i hapi shkollat, radiot, formonte

shoqata. Kështu diçka më gjerë ka bërë.

Ebru Süleyman: Shkollat e turqve u hapën prej '50-'51-tës, kishte në atë kohë, pastaj si u hoqën? Pse ndryshoi?

Münir Curi: '51-tën. Nuk ndryshoi gjë.

Ebru Süleyman: Domethënë ndonjë tërheqje, diçka të tillë nuk kishte të '70-tave…

Münir Curi: '51-tën kishte shkollë fillore dhe një shkollë e mesme turke ishte, ishte gjimnazi, tjetër nuk kishte, e tjetër nuk kishte. Ne ishim të detyruar, unë shkollën e mesme në gjuhën serbe e përfundova. Pasi që dija serbisht, për zanat, Shkollën e Lartë Profesionale në Mitrovicë në gjuhën serbe e përfundova. Sepse nuk kishte, turqisht nuk kishte. Vetëm gjimnaz turk kishte. Prandaj unë prej gjimnazit ika, dola, në zanat u ktheva por kam pasur shumë sukses. Serbisht jemi arsimuar, unë serbishten shumë mirë e njihja, sepse në lagje kishim gjithmonë serbë. Edhe ata flisnin turqisht. Ata mua serbisht më mësonin, unë ata turqisht i mësoja. Kështu që u mësuam, ata më shumë, këtu 90 për qind turiqsht flisnin, qytetarët.

Ebru Süleyman: Domethënë në të gjithë qytetin e kanë ditur?

Münir Curi: I gjithë qyteti fliste turqisht, ata që ishin qytetarë.

Ebru Süleyman: E pas luftës kur jeni kthyer këtu, pastaj si jeni adaptuar prej fillimit domethënë?

Münir Curi: Po ku ta di, ne tashmë ishim mësuar. Jemi përshtatur, ashtu u kthyem çka të na jep Allahu. U kthyem nëpër puna, i kishim punët. Disa vende të punës nuk u bënë, për shembull gruaja ime në televizion ka punuar, pas luftës nuk mundi të kthehej në punë. E kishim orkestrin, orkestri nuk u themelua. Në disa vende kështu na u kundërvynë por ja edhe këta qeveritarët tonë, asgjë prej tyre, as ata kurgjë s'po bëjnë. Nuk po munden apo nuk po dëshirojnë, po nëse do të dëshironin do të bënin, do të mund ta themelonin radion sepse kishte orkestër, komplet orkestër kishte.

Ebru Süleyman: Do të mund të vazhdonin?

Münir Curi: Do të mund të vazhdonin por nuk paska pasur buxhet, nuk e di çka nuk paska pasur, orkestër shqiptare nuk ka, orkestër turke nuk ka, nuk ka as orkestër turke. A bën ashtu? Por unë fajin kryetarit tonë, fajin ia lë kryetarit të PDTK[7]-së. Ai…

Ebru Süleyman: Nuk kanë punuar mjaft a?

Münir Curi: Nuk po e bën detyrën e vet. Nuk po e përfundon detyrën.

Ebru Süleyman: Tani jeni i pensionuar?

Münir Curi: I pensionuar.

Ebru Süleyman: Në shtëpi, me familjen.

[7] Partia Demokratike Turke e Kosovës

Münir Curi: Në shtëpi, me pesë veta. Me familjen aty në shtëpi (buzëqesh). Po dal po shëtitem nga pak. Po dal në Çarshi, në Çarshi asnjë shok nuk po e gjej. Për një orë të gjithë Çarshinë e shëtis, asnjë i njohur, domethënë prishtinas nuk ka. A janë shpërngulur të gjithë, apo kanë dal diku. Domethënë jeta… jo pak shumë pak, një njeri a e shoh apo nuk e shoh brenda javës. Jo… Nuk kemi ndonjë vend aq të veçantë.

Ebru Süleyman: Unë nuk po e di çfarë t'ju pyes më shumë, nëse dëshironi edhe diçka mund të vazhdoni të na tregoni?

Münir Curi: Nuk po e di as unë çka më shumë. Më ke pyetur këtu lidhur me shkrimtarët apo jo?

Ebru Süleyman: Po, nëse ka ndonjë që e njihni. Apo ndoshta mund të tregoni cila traditë ka qenë më herët e që tani nuk është më.

Münir Curi: Ne kishim shkrimtarë, letrarë. Süreyya Yusuf[8], profesor doktor Süreyya Yusuf letrar, shkrimtar. Pastaj është Hasan Mercan[9] prej shkrimtarëve në Kosovë. E në Maqedoni ishte Şükrü Ramo[10] , ky Necati Zekeriya[11], ne i lexonim librat e tyre, i lexonim ato [veprat] e tyre. E prej Kosovës i ndjeri Süreyya Jusuf, Enver Baki ishte. Ishte i ndjeri Naim Şaban[12], edhe ai prej shkrimtarëve. I lexonim librat e tyre. Kush ishte ende, i kam shkruar këtu diku por… Naim Şaban, Hasan Mercan, këta, Fahri Kaya[13], shkrimtarët tonë maqedonas. Këta, Necati Zekeriya, Şükrü Ramo, ata janë prej Maqedonisë por shkrimtarë turk. Ishtë një pyetje këtu e lexova atë. Kasabali[14] çfarë kuptimi ka?

Ebru Süleyman: Sipas jush çfarë kuptimi ka?

Münir Curi: Sipas teje çfarë kuptimi ka *kasabali* a e din?

Ebru Süleyman: Ndoshta për secilin është ndryshe. Ju si po e kuptoni?

Münir Curi: *Kasabali* kur thua domethënë është i qytetëruar. Më i qytetëruar i klasit më të lartë, domethënë më i ngritur se fshatari. Më i arsimuar, më i civilizuar. Kur thua *kasabali* domethënë më i qytetëruar, më i arsimuar dhe i klasit më të lartë.

Ebru Süleyman: Po, domethënë pak më elitë. E pse kështu, domethënë që janë shkolluar, apo tradita ka qenë ashtu?

Münir Curi: Shiko tani, këtu kur ka qenë shteti Osman gjuha zyrtare ka qenë turqishtja. Kështu që qytetërimin e kanë marr prej aty. Qytetërimin prej osmanëve e kanë marr edhe serbët, në qytet secili qytetar, edhe serbët edhe shqiptarët flisnin turiqsht. Domethënë më të qytetëruar, më… për ata kështu.

---

[8] (1923-1977), turkolog dhe shkrimtar
[9] (1944), poet dhe shkrimtar turk
[10] (1918), poet dhe shkrimtar turk
[11] (1928-1988), gazetar dhe shkrimtar
[12] (1935-1961), poet
[13] (1930-2020), mësues, tregimtar dhe poet turk
[14] Qytetar, bashkëqytetar

Ebru Süleyman: Tani më nuk është ashtu. Tani kjo ka ndryshuar…

Münir Curi: Tani gjuha zyrtare u bë shqipja, tani më shumë e përdorin shqipen. Ka gjuhë serbe por ashtu si zyrtare.

Ebru Süleyman: E ata njerëzit ne që ju thoshim *kasabali* ata tani në çfarë gjendje janë?

Münir Curi: Po ata e përdorin turqishten. Ishte një historian shqiptar Osi, Osi… ia harrova emrin. Në Amerikë ka doktoruar për histori, thoshte "Unë kur vija në qytet, e kur shikoja a është qytetar, apo fshatar, unë vetëm një gjë e pyesja, 'A flet turqisht?', nëse thoshte nuk e di ai nuk ishte *kasabali*." Historian nga Amerika Osi, Osi historian shqiptar. Thoshte, "Unë kur vija në qytet, e kur shikoja a është qytetar, apo fshatar, unë vetëm një gjë e pyesja, 'A flet turqisht?', nëse thoshte jo, domethënë fshatar është, *kasabali* nuk është". Sepse çdo *kasabali* e fliste turqishten. Më i arsimuar më…

Ebru Süleyman: Domethënë tregon se qëmoti ka qenë këtu.

Münir Curi: Po, qëmoti këtu, *kasabali*. Në atë kohë gjuhë zyrtare ka qenë turqishtja në periudhën Osmane, deri në vitin 1912 paska qenë këtu shteti Osman dhe gjuha zyrtare paska qenë turqishtja.

Ebru Süleyman: A ka edhe diçka që dëshironi të tregoni?

Münir Curi: Unë nuk kam, kaq.

Ebru Süleyman: Nëse nuk keni atëherë ju falemnderit shumë për kohën.

Münir Curi: Jo bijë hajt, valla për ty se…

1.